



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR
PUSHTETIN VENDOR



TREGUESIT E PERFORMANCËS SË BASHKIVE: NJË DEKADË TRANSFORMIMI NGA REFORMA ADMINISTRATIVO - TERRITORIALE VËSHTRIMET SIPAS CENSUSIT 2023 DHE SFIDAT E SË ARDHMES





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR
PUSHTETIN VENDOR



Ky botim mbështetet nga 'Bashki të Forta', projekt i
Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC
dhe Qeverisë së Suedisë, i zbatuar nga Helvetas.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht
qëndrimet e Qeverisë së Zvicrës apo të Suedisë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Sweden
Sverige

PËRMBAJTJTA

Parathënie.....	4
Përmbledhje ekzekutive	5
Hyrje	7
Metodologjia	8
Korniza analitike dhe kategorizimi i të dhënave.....	10
Dekada e Reformës Administrativo - Territoriale	11
Historiku	11
Të ardhurat e Veta dhe Tranfertat e pakushtëzura	12
Detyrimet e prapambetura.....	13
Shpenzimet.....	14
Menaxhimi Financiar	15
Realizimi i buxhetit dhe përdorimi i të ardhurave	15
Shërbimet	18
Arsimi	18
Ujitja dhe Kullimi	19
Pyjet dhe kullotat	21
Mbrojtja nga zjarri	22
Menaxhimi i mbetjeve	23
Shërbimet sociale	25
Uji i pijshëm dhe kanalizimet	27
Qeverisja dhe transparencë	28
Burimet njerëzore.....	28
Shkalla e rotacionit	28
Përqindja e stafit të trajnuar	29
Raporti punonjës për banorë	29
Transparenca dhe llogaridhënia	29
Barazia Gjinore	30
Përfundime dhe Sfidat.....	33
Anekset	35
Aneks A. Tabela e klasifikimit/kategoritë	35
Aneks B. Financat	37
Aneks C. Shërbimet	47
Aneks D. Qeverisja dhe transparencë	69

Lista e figurave

Figura 1: Buxheti, të ardhurat dhe shpenzimet	15
Figura 2: Treguesit e të ardhurave të bashkisë.....	16
Figura 3: Përdorimi i të ardhurave dhe buxhetit	16
Figura 4: Investimet	17
Figura 5: Indikator i arsimit parashkollor	18
Figura 6: Treguesi i kanaleve të ujitjes dhe kullimit sipas madhësisë së bashkive dhe llojit të përbërjes së tokës	20
Figura 7: Harta e Shqipërisë, sipas përbërjes së tokës	21
Figura 8: Fond pyjor dhe kullosor me plane mbarështimi	22
Figura 9: Numri i zjarrfikësve për 1500 banorë.....	23
Figura 10: Treguesit lidhur me menaxhimin e mbetjeve	24
Figura 11: Harta e familjeve (në %) në ndihmë ekonomike	25
Figura 12: Indikator i shërbimit social.....	26
Figura 13: Furnizimi me ujë të pijshëm dhe treguesit sanitarë.....	27
Figura 14: Indikator i burimeve njerëzore	28
Figura 15: Indikator i transparencës	30
Figura 16: Përqindja e grave në pozicione drejtuese	30
Figura 17: Fondet e donatorëve dhe totali i projekteve	31

Lista e tabelave

Tabela 1: Vlerësimi i fushave	8
Tabela 2: Tabela e klasifikimit	36

Lista e grafikëve


Grafiku 1: Progresi i të ardhurave të veta ndaj transfertës së pakushtëzuar 2015-2023.....	12
Grafiku 2: Progresi i detyrimeve të prapambetura 2015-2023	13
Grafiku 3: Raporti i detyrimeve në % ndaj të ardhurave 2015-2023.....	14
Grafiku 4: Progresi i shpenzimeve të pushtetit vendor 2015-2023.....	14

AKRONIMET

AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjen Vendore
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve
AKEM	Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve
BE	Bashkimi Europian
BtF	Bashki të Forta
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
GNP	Grupi Ndërinstitucional i Punës
KE	Këshilli i Evropës
NJVV	Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore
MIE	Ministria e Infstrukturës dhe Energjisë
MSHPV	Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor
MZSH	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
OJQ	Organizatë jo Qeveritare
QQ	Qeverisje Qendrore
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
SHAV	Shoqata për Autonominë Vendore
SHKQSH	Shoqata e Këshillave të Qarqeve
SMP	Sistemi i Matjes së Performancës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

Ky raport nuk ka analizuar të dhëna personale, për të ruajtur konfidencialitetin.

I gjithë procesi i përpunimit të të dhënave është mbështetur në detyrimet e parashikuara të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2018 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar



Parathënie

Z. Arbjan Mazniku

Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor

Me kënaqësi ju paraqes raportin e performancës së njësive të vetëqeverisjes vendore. Qëllimi i këtij ushtrimi është evidentimi i funksionimit të bashkive një dekadë pas miratimit në Kuvend të Reformës Administrative-Territoriale dhe të dhënat e reja të CENS-it 2023.

Bashkitë janë ofruesit kryesorë të shërbimeve në territor dhe nga viti 2015 kanë shtuar përgjegjësitë me funksione shtesë duke rritur edhe kapacitet e tyre ekonomike. Të ardhurat për frymë që prej vitit të parë të reformës pothuaj janë 4-fishuar.

Raporti paraqet rezultatet dhe evidenton progresin e bashkive, si dhe identifikon fusha ku janë të nevojshme përmirësime dhe ndryshime. Indikatorët e performancës janë përlogaritur në bazë të rezultateve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023.

Jam i bindur se bashkitë do të reflektojnë mbi sfidat dhe problematikat e shfaqura. Qëllimi kryesor është funksionimi i bashkive me standarde më të larta dhe të përgatitura për procesin e integritimit evropian. Aftësia përthithëse e projekteve është rritur dhe ky rezultat pasqyrohet në të dhënat e raportit.

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time për të gjithë punonjësit e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, Kryetarët e Bashkive dhe Kryetarët e Qarqeve. Gjithashtu dëshiroj të falenderoj partnerët tanë nga projekti “Bashki të Forta” i financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria Suedeze dhe zbatuar nga HELVETAS.

Në pritje të diskutimit të këtij raporti me bashkitë, mbetem i përkushtuar për të ndërmarrë hapat e nevojshme për të çuar përpara progresin në të gjitha nivelet e Qeverisjes.

Arbjan Mazniku
Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor
Këshilli i Ministrave
Nëntor 2024

Përmbledhje ekzekutive

Një dekadë pas Reformës Administrative Territoriale

Përmirësimi i funksionimit të bashkive dhe rritja e autonomisë së tyre, ishte objektivi kryesor i reformës administrative territoriale. Procesi u shoqërua me decentralizim funksionesh dhe burime financiare të shtuara.

- **Shpenzimet e buxhetit vendor** si përqindje e PBB-së, është rritur nga 2,4 % në vitin 2015 në 3,2% në vitin 2023.
- **Shpenzimet për paga** në vitin 2014 përbënin 70% të totalit të shpenzimeve. Në vitin 2023 pagat përbëjnë 43% të shpenzimeve ndaj totalit.
- **Pas Reformës Administrative Territoriale:** pushteti vendor ka luajtur një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në ekonomi. Kjo rritje reflektohet në kontributin me të ardhurat vendore që është rritur nga 0.82% e PBB-së në vitin 2015 në 1.37% në vitin 2023.
- **Të ardhurat e veta:** të ardhurat e bashkive për vitin 2023 arritën në 35 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 166% krahasuar me 2015. **50% e NJVV-ve** në vitin 2014 gjeneronin jo më shumë se 2% të buxhetit nga të ardhurat e veta. Të ardhurat e veta në vitin 2023 përbënin 51% të buxheteve totale të bashkive, nga 36% në vitin 2015. Në 2023 të ardhurat e veta për frymë rezultojnë në vlerën 14.527 lekë/banorë, ndërkohë që në 2015 ato rezultojnë vetëm 4.634 lekë/banorë. **50% e NJVV-ve** në vitin 2014 gjeneronin jo më shumë se 2% të buxhetit nga të ardhurat e veta. Kjo rritje reflekton aftësinë e përmirësuar të bashkive për të gjeneruar të ardhura, gjë e cila ka sjellë zgjerimin e ofrimit të shërbimeve dhe investimeve.
- **Taksa e pasurisë:** është rritur me 60%, nga 3.9 miliardë lekë që ishte në vitin 2015 tek 6.18 miliardë lekë në vitin 2023.
- **Transferrat qeveritare:** Transferrat e pakushtëzuara kanë pasur një rritje më të vogël prej +40% gjatë së njëjtës periudhë.
- **Detyrimet e prapambetura:** bashkitë kanë arritur të pakësojnë vlerën nga 12 miliardë lekë në vitin 2015, në rreth 5 miliardë lekë në vitin 2023.
- **Investimet:** për fryme për periudhën 2015-2023 janë rritur me 78%, përkatësisht nga 3.773 lekë në vitin 2015, në 6724 lekë në vitin 2023
Gjatë vitit 2023, pushteti vendor shpenzoi 16.56 miliardë lekë për investime. **Kjo shumë përbën 47% të të ardhurave të veta vendore.**
- **Integrimi Evropian:** gjatë kësaj dekade vihet re numri i lartë i projekteve të fituara nga bashkitë, përmes programeve të Bashkimit Evropian. Për 53 NJVV përfituese për vitin 2023, vlera totale e granteve nga projektet arrin në vlerën 46,174,419 €.
- **Strukutra e MZSH:** në të gjithë territorin disponon 213 mjete, nga 110 mjete që ishin në vitin 2015. Numri i punonjësve për këtë shërbim është 1315 për vitin 2023, nga 705 punonjës në vitin 2015.
- *Në vitin 2015 bashkitë nuk dispononin asnjë mjet për nevojat e funksionit ujitje-kullim.* 101 mjete eskavatorë u shpërndanë nga qeverisja qendrore ndaj 61 bashkive, në vitin 2016.
- **Para reformës 373** njësi të qeverisjes vendore (308 komuna dhe 65 bashki) kishin shpenzime administrative shumë të larta për shkak të vetë numrit të madh të tyre. Kalimi me 61 bashki ka ulur shpenzimet administrative me rreth 30%.

PERFORMANCA 2023 sipas CENS-it 2023

- **Të Ardhurat e Veta:** Në përlogaritje mesatare, të ardhurat e veta përbëjnë 51% të buxheteve totale të bashkive. Tirana udhëheq në gjenerimin e të ardhurave, me 82% të buxhetit të saj, ndërsa bashkitë më të vogla kanë një varësi të madhe nga transfertat e qeverisë qendrore.

Shfrytëzimi i të ardhurave dhe realizimi i buxhetit: Bashkitë më të vogla tregojnë realizim më të lartë se bashkitë më të mëdha, me norma më të larta të realizimit të buxhetit (76% krahasuar me 60% që është mesatarja kombëtare) dhe një shfrytëzim më efektiv të të ardhurave. Tirana has vështirësi në realizimin e buxhetit (54%).

Investimi për Frymë: Bashkitë më të vogla realizojnë investime më të larta për frymë 8,912 lekë krahasuar me bashkitë e mëdha të cilat këtë normë e kanë 5,004 lekë. Tirana shënon normën më të lartë të investimeve për frymë me 9,546 lekë.

- **Arsimi:** Bashkitë më të vogla kanë shkallë regjistrimi në kopshte publike më të lartë (81%). E kundërta ndodh në Tiranë, ku kjo shkallë arrin në **44% në kopshtet publike** dhe 19% në institucionet private.
- **Ujitja dhe Kullimi:** Mirëmbajtja e sistemeve të ujitjes dhe kullimit tregon diferenca të konsiderueshme, ku lloji i tokës ka rol më të rëndësishëm se sa madhësia e bashkisë.
- **Menaxhimi i Pyjeve dhe Kullotave:** Pjesa më e madhe e bashkive nuk disponojnë plane mbarështimi për pyjet dhe kullotat. Vetëm 19% e sipërfaqes totale të pyjeve dhe kullotave në Shqipëri janë të pajisura me plane. Ndarja e fuqisë punëtore është e ulët, me më pak se 1 punonjës për pyje për çdo 1,000 hektarë.
- **Mbrojtja nga Zjarri:** Në nivel kombëtar, raporti është rreth 1 zjarrfikës për çdo 1,500 banorë, duke përmblusur standardet ligjore. Bashkitë më të vogla (deri në 10.000 banorë) kanë një tregues prej 4 zjarrfikësish për 1,500 banorë, ndërsa bashkitë më të mëdha, sidomos ato me popullsi mbi 50000, kanë mesatarisht 0.6 zjarrfikës.
- **Menaxhimi i Mbetjeve:** Bashkitë më të mëdha arrijnë një mbulim më të lartë të mbledhjes së mbetjeve dhe norma më të larta rikuperimi të kostove.
- **Shërbimet Sociale:** Shpërndarja e ndihmës ekonomike ndryshon ndërmjet rajoneve, me zonat më pak të zhvilluara që tregojnë varësi më të lartë nga mbështetja sociale. Zhvillimi ekonomik i Tiranës, sjell si rezultat numër më të vogël familjesh që kërkojnë ndihmë sociale.
- **Shkalla e rotacionit të punonjësve:** Bashkitë nën drejtimin e kryetarëve të rinj përballen me një normë më të lartë të rotacionit të punonjësve (17.1%), krahasuar me ato që drejtohen nga kryetarë të pandryshuar (10.3%).
- **Mundësia e Trajnimeve:** Tirana spikat me 14% të stafit të saj që përfiton trajnime, në diferencë me bashkitë më të vogla, ku vetëm 8-10% e stafit kanë përfituar trajnime.
- **Transparenca:** Shumica e bashkive përmblusnin detyrimet e tyre ligjore për transparencë, me mbi 91% të vendimeve të publikuara online dhe 88% konsultime publike të realizuara.
- **Barazia Gjinore:** Përfaqësimi i grave në rolet udhëheqëse mesatarisht është 44%, me norma më të larta në bashkitë më të mëdha.

Hyrje

Ky raport paraqet një analizë të performancës të bashkive për vitin 2023, duke vlerësuar aspekte për **ofrimin e shërbimeve, menaxhimin financiar, burimet njerëzore, qeverisjen dhe transparencën**. Në këtë dokument vihen në dukje arritjet dhe fushat që kërkojnë përmirësim. Gjetjet mbështeten në Sistemin e Matjes së Performancës (SMP) ku janë vlerësuar 61 bashkitë për 40 tregues performance. Për shkak të mungesës së të dhënave të plota, jo të gjithë treguesit e parashikuar janë përfshirë në këtë analizë.

Një Dekadë Decentralizimi: Në vitin 2014 u zbatua Reforma Administrative-Territoriale, e cila organizoi qeverisjen vendore në 61 bashki të shoqëruar me transferim të funksioneve nga Qeveria Qendrore. Në vijim kuadri u plotësua me aktet ligjore dhe nënligjore për të rregulluar veprimtarinë e pushtetit vendor.

Procesi i Sistemit të Performancës (SMP) rezultoi në mbledhjen e të dhënave përmes një instrumenti digjital sipas treguesve specifikë. Treguesit u përzgjedhën për të mbuluar një fushë të gjerë funksionesh dhe përgjegjësisht të bashkive. Edhe pse vlerësimi ofron informacione të vlefshme në lidhje me performancën e bashkive, ekzistojnë kufizime në të dhëna, që duhen marrë parasysh kur interpretohen gjetjet:

1. **Të dhënat:** Të dhënat e përdorura në këtë raport janë të kombinuara, nga bashkitë dhe institucionet qendrore dhe pavarësisht përpjekjeve për të verifikuar dorëzimet, ekziston mundësia e pasaktësive ose raportimeve të gabuara.
2. **Mungesa e regjistrave/sistemeve administrative:** Cilësia e të dhënave dhe plotëshmëria e tyre sigurohet nëpërmjet pasjes së regjistrave kombëtarë sipas shërbimeve dhe funksioneve.
3. **Inkoherencat në raportimin e të dhënave:** Mungesa e cilësisë së disa të dhënave, e cila u evidentua gjatë fazës së përpunimit dhe analizimit, ka çuar në përjashtimin e tyre nga analiza tërësore.

Të gjithë treguesit janë analizuar dhe përpunuar në përputhje me rezultatet e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023. SMP vlerësoi performancën e bashkive në fushat e mëposhtme:

1. **Menaxhimi Financiar:** Të ardhurat bashkiake, borxhi, ekzekutimi i buxhetit dhe rikuperimi i kostove.
2. **Performanca e Shërbimeve:** Arsimi parashkollor, bujqësi, menaxhimi i pyjeve dhe kullotave, mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi, menaxhimi i integruar i mbetjeve, shërbimet sociale dhe furnizimi me ujë dhe kanalizimet.
3. **Qeverisja, Burimet Njerëzore dhe Projektet:** Transparenca, përgjegjshmëria, barazia gjinore, menaxhimi i burimeve njerëzore si dhe përthithja e fondeve të huaja.

Metodologjia

Procesi ka përfshirë fazat e mëposhtme:

Faza e Përgatitjes: Sistemi i Matjes së Performancës është përgjegjësi e Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP), i krijuar me Urdhër të Kryeministrit Nr.17, datë 20.2.2023 i ndryshuar, për krijimin e GNP të udhëhequr nga MSHPV dhe përbëhet nga anëtarë të 9 ministrive përkatëse. Në vijim, funksionon edhe grupi Teknik i Punës, i kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AMVV-së, i cili përbëhet nga 11 anëtarë të ministrive përkatëse, 6 anëtarë të institucione të qeverisë qendrore dhe 2 anëtarë të shoqatave të qeverisjes vendore.

Vlerësimi i fushave	
Përmbushja e kompetencave të veta	Përmbushja e kompetencave të veta
	Nën kontrollin e bashkisë
	E rëndësishme nga pikëpamja financiare
Prioritet kombëtar	Prioritet Kombëtar
	Prioriteti Kombëtar/Sektorial
	Prioritet në procesin e anëtarësimit në BE
	E rëndësishme për donatorët
Përputhshmëria me SMP	Përputhshmëria me SMP
	Lejon krahasime me standardin

TABELA 1: VLERËSIMI I FUSHAVE

1

Faza e përzgjedhjes së treguesve

Faza e zgjedhjes së treguesve

- **Zgjedhja dhe zhvillimi i treguesve:** GNP miratoi 40 tregues që përfaqësojnë performancën në ofrimin e shërbimeve të bashkive. Për këtë qëllim, u zhvilluan takime me dhjetë grupe të posaçme, me ekspertë dhe partnerë të tjerë. Në këto takime morën pjesë 11 ministri kryesore, 37 bashki, Shoqata për Autonomi Vendore (SHAV), Shoqata e Këshillave të Qarqeve (SHKQSH), 7 organizata ndërkombëtare dhe 8 institucione qendrore të qeverisë.
- **Zhvillimi i pasaportës së treguesve:** Për të lehtësuar një kuptim të qartë dhe interpretim të njëtrajtshëm të secilit tregues, u krijua "Pasaportë Treguesi". Ky udhëzues ofroi përshkrime të detajuara të secilit tregues, duke përfshirë qëllimin e tij, metodologjinë dhe udhëzime mbi burimet e të dhënave të nevojshme për raportimin e saktë.

2

Faza e konsultimeve

- **Konsultimet me Qeverisjen Vendore:** Si pjesë e këtij procesi, u organizuan 2 takime konsultuese me bashkitë për të diskutuar dhe dakordësuar zgjedhjen e treguesve të SMP. Treguesit përfundimtarë u miratuan në mbledhjen e GNP.
- **Njoftimi zyrtar i procesit:** Në muajin shkurt, MSHPV njoftoi zyrtarisht kryetarët e bashkive për fillimin e procesit të Matjes së Performancës përmes shkresës zyrtare. U caktuan 61 koordinatorë, punonjës të NJVV-ve, për sigurimin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave brenda afateve të caktuara. AMVV caktoi 12 koordinatorë rajonalë, për mbarëvajtjen e procesit.
- **Identifikimi i burimeve të të dhënave:** të dhënat administrative dhe të dhënat operative. Identifikimi i institucioneve përpunues i të dhënave.

3

Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve

- **Standardizimi:** përcaktimi i procedurave, përgatitja e udhëzuesve dhe ngritja e help-desk për asistencë teknike.
- **Trajnimi:** U zhvilluan trajnime të dedikuara për personelin e bashkive. Këto sesione kishin si qëllim të aftësonin pjesëmarrësit me informacione dhe njohuritë e nevojshme për të mbledhur dhe raportuar të dhënat me saktësi. Trajnimi shpjegonte hapat për hedhjen e të dhënave në platformën digjitale dhe këshilla për identifikimin dhe burimin e të dhënave.

4

Faza e mbledhjes së të dhënave

- **Platforma digjitale:** Një platformë digjitale u zhvillua posaçërisht për të lehtësuar ushtrimin. Personeli i bashkive pati akses në këtë platformë, për të regjistruar të dhënat përkatëse sipas treguesve.

5

Sigurimi i cilësisë dhe verifikimi

- **Pastrimi dhe verifikimi i të dhënave:** Pas dorëzimit të të dhënave, u krye një analizë paraprake për të identifikuar pasaktësitë, në koordinim me bashkitë dhe me bazën e të dhënave kombëtare.
- **Cilësia e të dhënave:** janë përdorur gjerësisht filtrime të cilësisë duke përdorur të dhëna administrative bashkë me të dhënat e raportuara në mënyrë operative.
- **Vizualizimi i të dhënave:** përdorimi i tabelave, grafikëve dhe hartave për të **paraqitur treguesit dhe rezultatet në mënyrë efektive.**
- **Kufizimi në analiza:** Në rastet kur është përdorur si tregues referuar (për banorë), rezultati mbetet i kufizuar. Rezultati do të kishte saktësi më të plotë, nëse shoqërohej me faktorë të tjerë ponderimi, si sipërfaqja e territorit të bashkisë apo dendësia e popullsisë.
- **Shkrimi i raportit:** paraqitja e gjetjeve bazuar në qartësi, thjeshtësi dhe konçize.

Korniza analitike dhe kategorizimi i të dhënave

Për të ofruar një pasqyrë të detajuar dhe krahasuese të çdo shërbimi, analiza përdor këto kategorizime:

1. Madhësia e Bashkisë sipas Popullsisë së Banuar:

- deri në 10000 banorë
- 10000-50000
- 50000-150000
- Tiranë

BANORË	NR	BASHKITË	NGJYRA
0-10'000	15	Përmet, Dropull, Tepelenë, Pukë, Memaliaj, Pustec, Kolonjë, Selenicë, Himarë, Fushë Arrëz, Delvinë, Këlcyrë, Konispol, Libohovë, Poliçan	
10'000-50'000	33	Mirditë, Gjirokastrë, Kukës, Skrapar, Devoll, Finiq, Mat, Pogradec, Klos, Roskovec, Cërrik, Belsh, Peqin, Tropojë, Maliq, Kavajë, Librazhd, Gramsh, Vau Dejës, Divjakë, Shijak, Mallakastër, Prrenjas, Has, Kuçovë, Malësi e Madhe, Kurbin, Rrogozhinë, Sarandë, Bulqizë, Dimal, Patos, Vorë	
50'000-150'000	12	Berat, Shkodër, Korçë, Lezhë, Elbasan, Fier, Kamëz, Dibër, Lushnjë, Vlorë, Durrës, Krujë	
>150'000	1	Tiranë	

2. Dendësia e Bizneseve¹, e klasifikuar si raporti i bizneseve ndaj popullsisë:

- E ulët
- Mesatare
- E lartë

3. Lloji i Kompozitës së Tokës², e klasifikuar sipas sipërfaqes bujqësore/pyjore në raport me sipërfaqen totale:

- Kryesisht bujqësore
- Kombinim bujqësor dhe pyjor
- Kryesisht pyjore

¹ Kategorizimi në "të ulët", "të mesëm" dhe "të lartë" është bërë duke përdorur si pikë ndarëse devijimin nga devijimi standard i raportit të bizneseve për banorë. "Të ulët" i referohet atyre bashkive që kanë më pak se 40 biznese për 1,000 banorë, "të mesëm" = 30 - 70 biznese për 1,000 banorë, dhe "të lartë" i referohet atyre bashkive që kanë një përqendrim prej më shumë se 80 biznese për 1,000 banorë.

² Bashkitë janë kategorizuar sipas llojit dominues të përbërjes së tokës duke përdorur metodologjinë e mëposhtme: ato në të cilat toka bujqësore përbën mbi 50% të sipërfaqes totale klasifikohen si kryesisht bujqësore. Ndërsa, ato ku më shumë se 50% e territorit nga pyje dhe kullota konsiderohen kryesisht të pyllëzuara. Të gjitha bashkitë e tjera, që nuk përmbushin asnjë kriter, kategorizohen si me përbërje të përzier midis tokës bujqësore dhe pyllit.

Dekada e Reformës Administrativo - Territoriale

Historiku

Miratimi i ligjit nr.115, datë 31.07.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë” dhe puna për zbatimin e tij ka qenë dhe mbetet ndër prioritetet e qeverisë shqiptare. Kjo reformë e rëndësishme e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë u konsultua me grupet e interesit dhe partnerët e zhvillimit. Miratimi i këtij ligji i dha fund copëzimit të territorit, duke e organizuar qeverisjen vendore në 61 bashki nga 373 bashki e komuna që ishin përpara vitit 2015. Me ndarjen e re, këto njësi ofrojnë më shumë shërbime publike cilësore e moderne në shërbim të qytetarëve. Organizimi i ri territorial synonte rritjen e investimeve publike dhe mundësi më të mëdha për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Kjo reformë është baza e disa proceseve decentralizuese të ndërmarra në vijim nga qeveria shqiptare, qëllimi i të cilave ishte konsolidimi i bashkive të reja, zgjerimi dhe rritja e shërbimeve publike, rritja e investimeve, zhvillimi ekonomik vendor, efektiviteti dhe transparencja e qeverisjes. Miratimi i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i hapi rrugë procesit të decentralizimit të funksioneve:

1. Administrimi dhe menaxhimi i pyjeve dhe kullotave;
2. Administrimi dhe menaxhimi i kanaleve kulluese dhe ujitëse;
3. Administrimi dhe menaxhimi i arsimit parashkollor;
4. Administrimi dhe menaxhimi i rrugëve rurale;
5. Administrimi dhe menaxhimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi.

Reforma administrative-territoriale, shënoi një hap të rëndësishëm në zhvillimin e procesit të decentralizimit. Që prej vitit 2015, vëmë re përgjegjshmërinë e njësive të vetëqeverisjes vendore në shpenzimin e fondeve dhe administrimin e detyrimeve të prapambetura. Me përgjegjësitë e shtuara dhe situatën pozitive financiare, ndikimi vihet në dukje në rritjen e investimeve dhe përmirësimin e parametrave të shërbimeve. Nëse para reformës, një pjesë e konsiderueshme e njësive të vetëqeverisjes vendore, e përdornin buxhetin e tyre për shpenzimet e pagave dhe shpenzime operative, nga rezultatet e analizës vëmë re një ndryshim të qasjes.


Sot bashkitë e vendit, janë shndërruar në njësi operative multifunksionale, si rezultat i investimeve në infrastrukturë dhe projekte, duke përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve. Nëpërmjet rritjes së nivelit të grumbullimit të të ardhurave të veta dhe menaxhimit eficient të burimeve të tyre, kanë shënuar progres në forcimin e financave vendore dhe rritjen e autonomisë fiskale. Në vijim të ndryshimit të kuadrit rregullator, në vitin 2017 u miratua ligji “Për financat vendore”, i cili qartësoi kushtet dhe situatën financiare, në harmoni me konceptin politik të reformës administrative territoriale.

Në një dekadë pas reformës, mund të evidentohet qartazi roli thelbësor i njësive të vetëqeverisjes vendore, si aktori më i rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve publike në territor. Bashkitë në situatën aktuale, janë struktura më të fuqizuara, financiarisht të qëndrueshme dhe me volum më të lartë investimesh, në krahasim me bashkitë ose komunat përpara një dekade. Lidhur me nivelin e grumbullimit të të ardhurave bashkitë kanë rritur paraqitjen e tyre vit pas viti. Plotësimi i kuadrit ligjor, si dhe përdorimi i institucioneve të varësive si agjent tatimor, rasti i ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve, kanë ardhur në ndihmë të qeverisjes vendore.

Një tregues domethënës është reduktimi i detyrimeve të prapambetura, duke përmirësuar ndjeshëm klimën financiare-ekonomike të bashkive.

Të ardhurat e Veta dhe Tranfertat e pakushtëzura

Reforma administrative territoriale e vitit 2015 shënoi një ndryshim të rëndësishëm në pasqyrën financiare të bashkive shqiptare. Kjo reformë kishte si qëllim forcimin e qeverisjes vendore duke fuqizuar bashkitë me përgjegjësi të shtuar dhe burime financiare të përmirësuara. Seksioni në vazhdim përshkruan zhvillimet kryesore financiare që kanë ndodhur që nga reforma, duke ofruar një kontekst të nevojshëm për të kuptuar performancën aktuale të bashkive.



GRAFIKU 1: PROGRESI I TË ARDHURAVE TË VETA NDAJ TRANSFERTËS SË PAKUSHTËZUAR 2015-2023

Rritja e të Ardhurave: Që prej reformës territoriale të vitit 2015, bashkitë kanë pësuar rritje të ndjeshme të të ardhurave të veta duke arritur trefishimin e tyre, nga 13 miliardë lekë në vitin 2015 në 35 miliardë lekë në vitin 2023. Norma e rritjes së të ardhurave të veta në 2023 është 166% në krahasim me 2015.

Gjatë periudhës 2015-2023, të ardhurat e veta shfaqin tendencë në rritje të vazhdueshme me përjashtim të vitin 2020, ku vihet re rënie e këtij treguesi, si pasojë e impaktit nga pandemia globale Covid-19 dhe rrjedhim të politikave fiskale favorizuese për të lehtësuar vështirësitë ekonomike të hasura nga biznesi.


Nëse në analizë do të marrim të ardhurat e veta për frymë gjatë kësaj periudhe, vihen re diferencat e theksuara pas reformës territoriale. Në 2023 të ardhurat e veta për frymë llogariten në vlerën 14.527 lekë/banorë, ndërkohë që në 2015 ato rezultojnë vetëm 4.634 lekë/banorë. Kjo rritje reflekton aftësinë e përmirësuar të bashkive për të gjeneruar të ardhura, gjë e cila ka sjellë zgjerimin e ofrimit të shërbimeve dhe investimeve.

Transfertat nga qeveria qendrore: Në vitin 2015, të ardhurat e veta të bashkive shqiptare përfaqësonin vetëm 36% të të ardhurave të veta kundrejt transfertës së pakushtëzuar. Rritja graduale e peshës së të ardhurave të veta ndaj transfertave në periudhën e analizuar dhe me raportin në vitin 2023 shënon një rritje prej 51%, mund të konsiderohet si një hap i rëndësishëm drejt fuqizimit të decentralizimit dhe rritjes së autonomisë financiare për vetëqeverisjen vendore.

Disa bashki në Shqipëri kanë arritur një shkallë të lartë të vetëfinancimit, duke treguar përparim të rëndësishëm në drejtim të autonomisë financiare. Konkretisht në 2023, bashkia e Tiranës arrin një përqindje të ardhurash të veta prej 82%, ndërsa Himara dhe Saranda kanë respektivisht 71% dhe 69%. Kjo nënkupton që këto bashki mbështeten më pak në transfertat e pakushtëzuara nga qeveria qendrore dhe gjenerojnë të ardhura të mjaftueshme për të financuar aktivitetet dhe investimet e tyre. Ndërkohë që në 2015, bashkitë Tiranë (22%), Himarë (59%) dhe Sarandë (37%) kanë patur vlera mjaft të ulëta të këtij treguesi.


Buxheti si Përqindje e PBB-së: Reforma gjithashtu ka kontribuar në rritjen e buxheteve bashkiake si përqindje e PBB-së, duke u rritur nga 2,4 % në vitin 2015 në 3,2% në vitin 2023. Ky zgjerim thekson rëndësinë financiare në rritje të bashkive në ekonominë kombëtare.

Detyrimet e prapambetura




GRAFIKU 2: PROGRESI I DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA 2015-2023

Reduktimi i Borxhit dhe Detyrimeve: Në një analizë kohore të detyrimeve të prapambetura për periudhën 2015-2023, rezulton një përmirësim i dukshëm në uljen e tyre nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto detyrime të prapambetura në 2023 janë trefish më pak në krahasim me vitin 2015, përkatësisht nga rreth 12 miliardë lekë në rreth 4.8 miliardë lekë me një diferencë prej 7 miliardë lekësh më pak duke përmirësuar stabilitetin fiskal në bashki. Bashkitë kanë arritur të reduktojnë detyrimet financiare që prej fillimit të reformës dhe uljen e nivelit të borxhit nga 940 milionë lekë në vitin 2015 në 101 milionë lekë në vitin 2023.



GRAFIKU 3: RAPORTI NË % I DETYRIMEVE NDAJ TË ARDHURAVE 2015-2023

Shpenzimet



GRAFIKU 4: PROGRESI I SHPENZIMEVE TË PUSHTETIT VENDOR 2015-2023

Nga viti 2015 deri në vitin 2023, shpenzimet faktike të pushtetit vendor kanë shënuar një rritje të konsiderueshme prej 101%, duke shfaqur risi pozitive në financimin dhe mbështetjen për zhvillimin vendor. Kjo risi rritëse tek shpenzimet e njësive të qeverisjes vendore me burim financimi (të ardhurat e veta, transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale dhe taksat e ndara) arrin vlerën 68 miliardë lekë në 2023, rreth 10 miliardë lekë më shumë se 2022. Kjo rritje tregon një përforsim të buxhetit vendor, duke reflektuar një veçori të qëndrueshme rritjeje që nënvizon stabilitetin financiar të njësive vendore. Kjo qasje e rritjes së shpenzimeve lidhet me nevojën e shtuar për financim dhe për investime të reja, duke sinjalizuar përkushtim të njësive për përmirësimin e shërbimeve publike dhe përmbushjen e objektivave strategjik.

Menaxhimi Financiar

Qëllimi kryesor i menaxhimit të financave vendore është ofrimi i shërbimeve duke maksimizuar përdorimin e të ardhurave dhe duke siguruar burime financiare të qëndrueshme. Raporti vjetor i zbatimit të buxhetit vendor, përfshin raportin e performancës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, bazuar në raportin e monitorimit vjetor të buxhetit.

Realizimi i buxhetit dhe përdorimi i të ardhurave

Vlerësimi i performancës financiare në 61 bashki për vitin 2023 përfshiu 11 tregues financiarë të kategorizuar në të ardhura dhe shpenzime. Treguesit kryesorë përfshijnë: i) buxheti për frymë; ii) të ardhurat e veta për frymë; iii) investime për frymë; dhe iv) përqindja e realizimit të buxhetit.




FIGURA 1: BUXHETI, TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET

Analiza tregon se bashkitë më të vogla marrin buxhet më të lartë për frymë, bashkitë më të mëdha me një përqendrim më të lartë biznesesh gjenerojnë më shumë të ardhura nga burimet e veta. Shihen dallime të vogla në tregues si buxheti për frymë (mesatarisht 28,448 lekë) dhe realizimi i buxhetit (mesatarja kombëtare 60%) mes bashkive të madhësive të ndryshme. Bashkia Tiranë përbën një rast të veçantë, me një realizim më të ulët të buxhetit prej 54%. Kjo diferencë është veçanërisht e dukshme në të ardhurat nga burimet e veta për frymë, ku bashkitë me popullsi më të madhe ose me një përqendrim më të lartë biznesesh, gjenerojnë më shumë të ardhura vendore. Bashkitë Tiranë, Himarë dhe Sarandë dallohen me tregues rreth 3.5 herë mbi mesataren kombëtare.

Kategoria e treguesve të të ardhurave të bashkive përbëhet nga tre tregues të zgjedhur, të cilët janë: i) Të ardhurat e veta për frymë; ii) Pësja e të ardhurave të veta në buxhet (%); dhe iii) Shkalla e përdorimit të të ardhurave (të ardhurat kundrejt shpenzimeve) (%).

Të ardhurat e veta përfaqësojnë një pjesë të vogël të burimeve financiare totale të bashkive, ku mesatarja kombëtare është pak më shumë se gjysma e burimeve totale të buxhetit (51%).




FIGURA 2: TREGUESIT E TË ARDHURAVE TË BASHKISË

Figura 2 tregon se faktorë ekonomikë si madhësia e popullsisë dhe përqëndrimi i bizneseve luajnë një rol të rëndësishëm në mirë-menaxhimin financiar të NJVV-ve në Shqipëri. Gjatë vitit 2023, fuqia fiskale u përqëndrua në bashkinë Tiranë, me të ardhurat për frymë 32,862 lekë dhe pesha e të ardhurave të veta ishte 86% e totalit të buxhetit. Bashkitë e mesme (me popullsi 10,000 – 50,000 banorë) kanë të ardhura më të ulëta për frymë (7,088 lekë) dhe mbështeten më shumë te transfertat qeveritare (21%).

Kategoria e treguesve të shpenzimeve dhe investimeve të bashkive përbëhet nga katër tregues të zgjedhur që synojnë të nxjerrin në pah tregues të ndryshëm lidhur me shpenzimet, si: i) Shkalla e përdorimit të të ardhurave; ii) Realizimi i buxhetit; iii) Investime për frymë; iv) Realizimi i shpenzimeve për investime.




FIGURA 3: PËRDORIMI I TË ARDHURAVE DHE BUXHETIT

Qëndrueshmëria financiare e bashkive reflektohet në aftësinë e tyre për të menaxhuar detyrimet e prapambetura. Analiza tregon se bashkitë më të vogla, përkundër burimeve të kufizuara, shpesh shfaqin norma më të larta të përdorimit të të ardhurave dhe realizimit të buxhetit. Kjo është e dukshme në bashkitë me popullsi nën 10,000 banorë, të cilat arrijnë një normë të lartë të përdorimit të të ardhurave prej 82%. Bashkitë më të vogla janë më të varura nga transfertat sesa nga të ardhurat e veta.

Në zonat me përqendrim të lartë biznesi, mund të vërehet një konsolidim më i theksuar i fuqisë fiskale, duke qenë se bashkitë më të mëdha si Tirana, përkundër gjenerimit të lartë të të ardhurave të veta, hasin vështirësi në realizimin e buxhetit, duke treguar sfida potenciale në menaxhimin efektiv të detyrimeve financiare.




FIGURA 4: INVESTIMET

Kategoria e treguesve të investimeve të bashkive përbëhet nga dy tregues kryesorë i) Investime për frymë dhe ii) Realizimi i shpenzimeve për investime.

Ky grup treguesish ofron një pasqyrë të burimeve dhe dinamikës së investimeve në bashkitë e Shqipërisë, të kategorizuara sipas madhësisë dhe densitetit të bizneseve. Investimet në infrastrukturë mbeten të rëndësishme për qeverisjen vendore, me rezultate që tregojnë se bashkitë më të vogla kanë tendencën të investojnë më shumë për frymë, me mesatare që arrijnë deri në 8,912 lekë. Tirana dallohet për investime shumë më të larta për frymë, megjithatë, ajo tregon një normë të ulët të realizimit të buxhetit.

Të dhënat theksojnë nevojën për investime strategjike të mbështetura nga transfertat e qeverisë qendrore për të siguruar që buxhetet lokale të jenë të afta për të financuar infrastrukturën dhe shërbimet publike të nevojshme për komunitetet.

Në përmbledhje, menaxhimi efektiv financiar në nivel vendor përfshin jo vetëm realizimin e buxheteve dhe gjenerimin e të ardhurave, por menaxhimin e kujdesshëm të borxhit dhe investimet strategjike. Bashkitë më të vogla, ndonëse shpesh më efikase në përdorimin e burimeve të kufizuara, përballen me sfida në stabilitetin e financave.

Shërbimet

Arsimi

Arsimi parashkollor u transferua në vitin 2016. Ligji 139/2015 i ndryshuar përcakton se bashkitë janë përgjegjëse kryesisht për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave për arsimin parauniversitar, përveç shkollave profesionale, si dhe për administrimin dhe rregullimin e arsimit parashkollor publik në kopshte dhe çerdhe. Shumë aspekte të këtij shërbimi trajtohen në bashkëpunim me qeverinë qendrore. Ky funksion nuk është financuar mjaftueshëm, duke ndikuar në cilësinë dhe disponueshmërinë e arsimit³.

Gjendja e shërbimit arsimor në Shqipëri u vlerësua duke përdorur tre tregues kryesorë: normat e regjistrimit të arsimit parashkollor për fëmijët deri në 6 vjeç, niveli i mirëmbajtjes së objekteve arsimore⁴, dhe raporti fëmijë-mësues.

Sipas të dhënave të Censit, 90% e fëmijëve 6-vjeçarë aktualisht ndjekin shkollën fillore. Të dhënat mbi edukimin e hershëm tregojnë se mesatarja kombëtare e regjistrimit për fëmijët deri në 3 vjeç në institucionet publike është 9.9%. Bashkia Tiranë e tejkalon ndjeshëm këtë me një normë regjistrimi prej 12.9%, duke patur dhe normën më të lartë të mirëmbajtjes së godinave arsimore. Analiza eidenton faktin që 17 bashki nuk ofrojnë shërbime publike të çerdheve.

	Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike (0-3 vjeç)	Shkalla e regjistrimit në kopshte publike (3-6 vjeç)	Shkalla e regjistrimit në kopshte private (3-6 vjeç)	Shkalla e regjistrimit në <u>kopshte publike dhe private</u> (3-6 vjeç)	Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike	Niveli i mirëmbajtjes së objekteve arsimore (kopshte + arsim bazë)
Sipas popullsisë						
deri në 10'000	5.4	81.0	0.3	81.3	8.1	79.5
10'000-50'000	7.0	72.3	2.3	74.6	11.2	81.4
50'000-150'000	9.6	63.2	9.4	72.6	13.5	76.5
Tirana	12.9	44.3	19.2	63.5	18.8	100.0
Mesatarja kombëtare	9.9	60.1	10.2	70.3	13.0	79.9
Cens 2023	36.8			52.3		

FIGURA 5: INDIKATORI I ARSIMIT PARASHKOLLOR

Për fëmijët e moshës së kopshtit (3 deri në 6 vjeç), mesatarja kombëtare e regjistrimit në kopshte publike është 60.1%. Në përlllogaritje me institucionet private, mesatarja shkon në

³ Burimi UNICEF, "Policy options for Early Childhood Education Financing in Albania", Maj 2023

<https://www.unicef.org/albania/media/6081/file/Policy%20options%20for%20Early%20Childhood%20Education%20Financing%22%20in%20Albania.pdf>

⁴ Shkalla e mirëmbajtjes së objekteve shkollore është mjaft e lartë për shkak të metodës së llogaritjes. Në thelb, nëse një bashki shpenzon edhe vetëm 1 lek për një objekt (si për pagimin e faturave ose shpenzimeve të tjera), ai kategorizohet si "i mirëmbajtur." Numri total i objekteve të përfshira përfshin si çerdhet ashtu edhe ndërtesat e shkollave fillore.

70.3%. Bashkitë më të vogla tregojnë norma më të larta, duke arritur deri në 81%. Norma e regjistrimit në Tiranë është dukshëm më e ulët, vetëm 44.3%, për shkak të regjistrimit të një shkalle prej 20% në kopshtet private.

Raporti nxënës-mësues ndryshon ndjeshëm nëpër bashki të madhësive të ndryshme si dhe në sektorin publik e privat. Të dhënat tregojnë se mbipopullimi përgjithësisht nuk përbën problem, me raportet që përmbushin standardet e BE-së (13.4%). Diferenca ndërmjet këtij raporti në kopshte publike dhe private janë të dukshme, respektivisht 13:1 dhe 10:1.

Bashkitë më të mëdha, si Tirana dhe ato me popullsi mbi 50.000 banorë, tregojnë raportet më të larta, përkatësisht 18.8 dhe 13.5 në kopshte publike, duke theksuar nevojën për burime të shtuara arsimore në këto zona.

Analiza vë në pah aksesin dhe cilësinë e arsimit të hershëm nëpër bashki, me institucionet private që kompensojnë mungesat e sektorit publik në bashkitë më të mëdha dhe të zhvilluara. Standardet më të larta të mirëmbajtjes në Tiranë dhe normat më të ulëta të regjistrimit në kopshte sugjerojnë sfida dhe preferenca të ndryshme në mjediset arsimore urbane. Sistemi i arsimit parashkollor në Shqipëri kërkon ndërhyrje të fokusuara për të rritur normat e regjistrimit në edukimin e hershëm. Sistemi është nën vështirësi nga rënia demografike dhe deficieti i migracionit neto, së bashku me normat e ulëta të lindjeve. Shkaqet e normave të ulëta të regjistrimit duhet të shqyrtohen nga Bashkitë në mënyrë të hollësishme.

Ujitja dhe Kullimi

Funksioni i ujitje-kullimit për mirëmbajtjen e kanaleve dytësore dhe tretësore u transferua në vitin 2016 pranë bashkive. Gjatë këtyre viteve është synuar përmirësimi i këtij shërbimi duke investuar në mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture, për të ardhur në ndihmë të fermerëve dhe ekonomive vendore.

Shënim: Për trajtimin e funksionit ujitje - kullim, janë përdorur të dhënat e raportuara nga vetë bashkitë. Analiza e gjeneruar mund të sjellë devijime nga rezultati i saktë, pasi vlera e kanaleve në kilometra e raportuar nga bashkitë, nuk përputhet me vlerën e kanaleve në kilometra, e marrë nga ministria.

Ujitja dhe kullimi u analizua përmes dy treguesve kryesorë: niveli i mirëmbajtjes dhe përqindja e tokës bujqësore që përfshihet në sistemin transmetues të kanaleve. Të dhënat u mbledhën duke matur gjatësinë e kanaleve të pastruara, e shprehur në kilometra, në krahasim me gjatësinë totale të rrjetit. Sipas raportimeve nga bashkitë, në të gjithë territorin ekzistojnë rreth 15,000 kilometra kanale për ujitjen⁵ dhe 16,500 kilometra kanale për kullimin⁶. Mirëmbajtja e këtyre kanaleve është relativisht e ulët, me normë prej 23% për kanalet e ujitjes dhe 13% për ato të kullimit. Ndërkohë 47% e tokave bujqësore janë të pajisura me infrastrukturë ujitëse dhe kulluese.

5 Sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, gjatësia totale e kanaleve të ujitjes është 25,000 km, nga të cilat 2,000 km janë kanale kryesore, 6,200 km janë kanale sekondare dhe 16,800 km janë kanale të tretë.

6 Sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, gjatësia totale e kanaleve të kullimit është 15,700 km, nga të cilat 2,000 km janë kanale kryesore, 2,700 km janë kanale sekondare dhe 11,000 km janë kanale të tretë.

Rezultatet, të ilustruara në figurë, analizohen sipas madhësisë së bashkive dhe llojit të përbërjes së tokës⁷. Vihet re se në bashkitë e vogla mirëmbajtja në kanalet ujitëse arrin në shkallën 38%, ndërsa në bashkitë më të mëdha, të cilat kanë mbi 50.000 banorë, përqindja e mirëmbajtjes bie deri në 12%.




FIGURA 6: TREGUESI I KANALEVE TË UJITJES DHE KULLIMIT SIPAS MADHËSISË SË BASHKIVE DHE LLOJIT TË PËRBERJES SË TOKËS

⁷ Bashkitë janë kategorizuar sipas llojit kryesor të përbërjes së tokës duke përdorur metodologjinë në vijim: ato në të cilat toka bujqësore përbën mbi 50% të sipërfaqes totale klasifikohen si kryesisht bujqësore. Ndërsa, ato ku mbi 50% e territorit është e mbuluar me pyje dhe kullota konsiderohen si kryesisht të pyllëzuara. Të gjitha bashkitë e mbetura, që nuk përmbushin asnjë nga kriteret, kategorizohen si të kenë një përbërje të përzier të tokës bujqësore dhe të pyllit. Bazuar në këtë shpërndarje, kilometrat e kanaleve të ujitjes janë ndarë përafërsisht në mënyrë të barabartë mes tre grupeve, me secilin grup që përmban rreth një të tretën e rrjetit total të kanaleve të ujitjes.

■ Kryesisht pyje
■ Bujqësore & pyje
■ Kryesisht bujqësore




FIGURA 7: HARTA E SHQIPËRISË, SIPAS PËRBËRJES SË TOKËS

Në bashkitë me tokë kryesisht bujqësore, vetëm 15% e kanaleve të ujitjes janë mirëmbajtur⁸, ndërsa në ato me shumicë pyjesh dhe kullota, përqindja rritet në 40%. Karakteristikat e terrenit duket se e bëjnë më të lehtë dhe më ekonomik procesin e mirëmbajtjes. Terrenet kodrinore, kanë aftësi natyrore për pastrim dhe janë më pak të prirura për t'u bllokuar.

Një qasje strategjike është e domosdoshme për bashkitë për të menaxhuar në mënyrë efikase kanalet ujitëse. Duke identifikuar dhe planifikuar nevojat specifike për mirëmbajtje të terreneve të ndryshme, bashkitë mund të organizojnë procesin e mirëmbajtjes dhe të

shpërndajnë më mirë burimet e tyre. Kjo do të sigurojë që kanalet e ujitjes dhe kullimit të ruhen në kushte optimale, duke mbështetur sektorin bujqësor dhe ekosistemet lokale.

Pyjet dhe kullotat

Pas Reformës Administrative Territoriale, bashkitë në Shqipëri morën përgjegjësitë për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe kullotave, përjashtuar zonat e mbrojtura.

Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave u vlerësua duke përdorur dy tregues: mbulimi me plane të mbarështimit të pyjeve, i cili është raporti i sipërfaqeve me këto plane ndaj sipërfaqes totale të pyjeve dhe kullotave, dhe nivelet e stafit, të matur nga numri i punonjësve për 1,000 hektarë. Rezulton se bashkitë Berat, Has, Maliq, Sarandë dhe Tiranë kanë plane mbarështimi të pyjeve. Rreth dy të tretat e bashkive nuk disponojnë asnjë plan. 19% e 1.4 milion hektarëve të pyjeve dhe kullotave sipas të dhënave të raportuara nga vetë bashkitë në Shqipëri janë mbuluar me plane mbarështimi. Shpërndarja e forcës punëtore ndjek një tendencë të ngjashme me mesataren kombëtare, më pak se një punonjës për 1000 hektarë. Analiza thekson nevojën për përmirësimin e menaxhimit të pyjeve dhe kullotave për shkak të mungesës së planeve të mbarështimit në shumë bashki dhe nivelit të stafit nën mesataren e BE-së.

⁸ Të dhënat e për kilometrat e kanaleve ujitëse dhe kulluese nuk janë të besueshme.




FIGURA 8: FOND PYJOR DHE KULLOSOR ME PLANE MBARËSHTIMI

Mbrojtja nga zjarri

Ky funksion është transferuar pranë NJVV-ve në vitin 2016. Në vazhden e Reformës Administrative Territoriale, në përfundim të vitit 2018 janë ngritur stacionet zjarrfikëse në çdo bashki, me personel minimal prej 14 punonjësish.

Analiza e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit përfshin dy tregues kryesorë: numrin e zjarrfikësve për çdo 1500 banorë dhe numrin e automjeteve zjarrfikëse për çdo 10.000 banorë. Në nivel kombëtar, ka rreth 1 zjarrfikës për 1500 banorë. Një tendencë e ngjashme vërehet edhe me disponueshmërinë e automjeteve zjarrfikëse, e cila zvogëlohet me rritjen e madhësisë së bashkive.

- Bashkitë e vogla kanë më shumë zjarrfikës dhe automjete zjarrfikëse për frymë se bashkitë e mëdha. Kjo mund të jetë për shkak të shpërndarjes së popullsisë në zonat rurale, ku distancat janë më të mëdha dhe infrastruktura rrugore mund të jetë më e vështirë.
- Tirana ka numrin më të ulët të zjarrfikësve dhe automjeteve zjarrfikëse për frymë. Kjo mund të jetë për shkak të përqendrimit të popullsisë dhe infrastrukturës më të mirë rrugore në kryeqytet.
- Mesatarja kombëtare është më afër shifrave të bashkive të mëdha. Kjo tregon se bashkitë e mëdha kanë një peshë më të madhe në llogaritjen e mesatares kombëtare.




FIGURA 9: NUMRI I ZJARRFIKËSVE PËR 1500 BANORË

Menaxhimi i mbetjeve

Në kuadër të zbatimit të ligjit 139/2015, të ndryshuar, bashkitë kanë detyrimin për të menaxhuar mbetjet e ngurta, duke përfshirë mbledhjen, transportin, trajtimin dhe asgjësimin e tyre. Vlerësimi për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve nga ana e bashkisë, bazohet në tre tregues, siç është mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, shkallën e mbulimit të kostos sipas tarifës së shërbimit dhe efikasitetin e kostos.

Shënim: Për analizimin e funksionit të menaxhimit të mbetjeve janë përdorur të dhënat e raportuara nga bashkitë. Mbi përllogaritjen e treguesve të PMS 2023 janë përdorur rezultatet e Cens 2023 dhe përjashtim në këtë fushë bën treguesi mbi mbulimin e popullsisë me menaxhimin e mbetjeve, i cili është raportuar nga bashkitë referuar popullsisë së regjistruar dhe jo popullsisë rezidente bazuar në Cens 2023. Analiza e gjeneruar merr në konsideratë vetëm për këtë tregues, tjetër bazë metodologjike, duke sjell deformime të rezultatit.

Në nivel kombëtar rezulton se 68% e kostove për menaxhimin e mbetjeve mbulohen nga tarifat e shërbimit, nga ku mesatarja e kostos për mbledhjen e 1 ton mbetje në Shqipëri paraqitet afërsisht 8.830 lekë.

Figura 10 tregon performancën e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Në vitin 2023, Shqipëria mbledhi rreth 835,000 ton mbetje, me një gjenerim mesatar për frymë prej 348 kg në vit. Ndërsa shifrat e vetëraportuara tregojnë se 99% e popullsisë është e mbuluar nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Bashkitë më të mëdha tregojnë mbulim më të madh, për shkak të infrastrukturës, investimeve, si dhe vendbanimeve urbane më të dendura.

Shifrat kombëtare tregojnë se 68% e kostove për menaxhimin e mbetjeve mbulohen nga tarifat e shërbimit. Bashkitë më të vogla raportojnë përqindje më të ulët të mbulimit prej vetëm 45%.

Ligji përcakton që shpenzimet ndahen mes familjeve dhe bizneseve. Në vitin 2023, vetëm gjashtë bashki arritën të mbulojnë plotësisht kostot e tyre përmes tarifave: Berat, Mat, Devoll, Bulqizë, Lushnjë dhe Kuçovë.

Mesatarja e kostos për mbledhjen e një ton mbetjesh në Shqipëri arrin rreth 8,830 lekë. Bashkitë më të vogla përballen me shpenzime më të larta. Bashkitë me madhësi të mesme tregojnë një

balancë të mirë të efikasitetit të kostos. Bashkitë më të mëdha, përfshirë Tiranën, përballen me shpenzime më të larta.

Kur krahasohen dy modelet e menaxhimit të mbetjeve, ato që menaxhohen nga bashkitë dhe ato që janë nënkontraktuar, shërbimet e nënkontraktimit duket se janë më efektive në të dyja aspektet, mbulimit dhe rikuperimit të kostove. Ky efikasitet mund t'i atribuohet ekspertizës së specializuar dhe kapaciteteve operative të sektorit privat.


	Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve (%)	Mbetje të gjeneruara (kg/banorë)	Norma e mbulimit të kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve (%)	Efikasiteti i kostos (lekë/ton)
Sipas popullsisë				
deri në 10'000	80	333	45	11,403
10'000-50'000	85	290	59	8,837
50'000-150'000	96	326	81	7,161
Tirana	100	418	88	10,189
Densiteti i bizneseve				
I ulët	84	229	60	9,158
I mesëm	89	302	75	8,822
I lartë	95	695	46	9,549
Mënyra e menaxhimit				
Nën-kontraktim	90	351	68	9,153
Vetë-administrim	81	258	51	9,169
Mesatarja kombëtare	99	348	68	8,830

FIGURA 10: TREGUESIT LIDHUR ME MENAXHIMIN E MBETJEVE

Shërbimet sociale

% e familjeve në ndihmë ekonomike

- ≥ 20
- 15-20
- 5-15
- < 5



Në Shqipëri, sistemi i shërbimeve sociale funksionon në bazë të një strukture të ndarë midis qeverisë vendore dhe asaj qendrore. Kjo ndarje e detyrave bën që autoritetet vendore të fokusohen në dokumentacionin fillestar, ndërsa autoritetet qendrore marrin vendimet kryesore për shpërndarjen e ndihmave.

FIGURA 11: HARTA E FAMILJEVE (NË %) NË NDIHMË EKONOMIKE

Sa i përket financimit, vihet re një hendek i konsiderueshëm në burimet për shërbimet sociale në nivelet vendore dhe kombëtare. Financimi aktual është kryesisht i orientuar drejt ndihmës ekonomike dhe përfitimeve për personat me aftësi të kufizuara, duke lënë një mungesë të rëndësishme në fusha të tjera të kujdesit social. Ky hendek mbulohet kryesisht nga organizatat joqeveritare (OJQ),⁹ të cilat kanë marrë rolin e ofruesve kryesorë të shumë shërbimeve të domosdoshme.

Vlerësimi i shërbimeve sociale në nivel vendor u përqendrua në tre tregues kryesorë: përqindja e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, normat e miratimit për strehimin social dhe numri i qendrave të shërbimeve sociale në raport me popullatën. Figura në vijim ilustron shpërndarjen dhe efikasitetin e shërbimeve sociale në Shqipëri, duke paraqitur një panoramë të ndikuar nga kushtet ekonomike të çdo rajoni. Në mbarë vendin, rreth 8% e familjeve përfitojnë ndihmë ekonomike, ndërsa norma e miratimit për strehimin social është 40%. Zhvillimi ekonomik duket se ka një ndikim më të madh në shpërndarje sesa madhësia e bashkisë. Për bashkinë e Tiranës 1.2% e familjeve përfitojnë ndihmë ekonomike, një shifër shumë më e ulët se mesatarja kombëtare.

Bashkitë me densitet të ulët biznesi, tregojnë një varësi më të lartë nga ndihma ekonomike. Rajoni lindor i Shqipërisë (zonat e kuqe në hartë), i njohur për zhvillimin ekonomik të kufizuar, ka të paktën 15% të familjeve që përfitojnë ndihmë.

⁹ Burimi: UNDP, Mapping of Social Services in Albania, 2023.
https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2023-11/mapping_eng_web.pdf

Për t'iu përafuar metodologjisë mbi përqindjet e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike duhet të merret në konsideratë numri i individëve/familjeve që jetojnë nën kufirin e varfërisë. Nëse merren në raport këto familje, rezultojnë 32% të familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike. Aktualisht 95% e aplikuesve për ndihmë ekonomike janë përfitues të kësaj skeme¹⁰.

Aktiviteti ekonomik ka një ndikim të konsiderueshëm në kërkesën për shërbime sociale në Shqipëri, **me rajonet më pak të zhvilluara që tregojnë nevoja më të theksuara.**




FIGURA 12: INDIKATORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Nuk ka një korrelacion të qartë midis përqindjes së familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe shkallës së miratimit të strehimit social. Kjo sugjeron se faktorë të tjerë, siç janë politikat e strehimit dhe disponueshmëria e shtëpive, ndikojnë në shkallën e miratimit të strehimit social.

¹⁰Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Uji i pijshëm dhe kanalizimet

Sektori i ujit të pijshëm dhe kanalizimeve vepron sipas një sistemi me dy nivele: qeveria qendrore zhvillon strategjitë dhe politikat sektoriale, ndërsa qeveritë vendore janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve dhe kanë autonominë për të vendosur tarifat e tyre. 61 bashki janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve përmes ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve. Këto ndërmarrje janë të organizuara si shoqëri aksionare dhe kanë nivele të ndryshme të pavarësisë vepruese dhe financiare në raport me bashkitë. Shumica e ndërmarrjeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve në Shqipëri janë të varura nga financimi i qeverisë qendrore për investimet kapitale.

Duke marrë parasysh situatën komplekse të infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimeve, kjo analizë përqendrohet në aksesin me furnizimin me ujë dhe në aksesin në kanalizime.

Sipas të dhënave të siguruara nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), ekzistojnë rreth 955,000 kontrata familjare për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime, ndërkohë që numri i banesave në Shqipëri rezultoi 1,802,529 sipas Cens-it të vitit 2023 si pasojë niveli i mbulimit kombëtar me ujë të pijshëm është rreth 88%. Referuar përqindjes së banesave të pajisura me kanalizime, e dhënë e raportuar nga vetë bashkitë rezultojnë me një mesatare kombëtare prej 61%.

Tirana reflekton përqindjen më të lartë të numrit të kontratave për ujin e pijshëm (110%) dhe kanalizimet (90%), ndërkohë që në bashkitë e vogla deri 10000 banorë kanë përqindjen më të ulët të banesave të pajisura me kanalizime (32%)

Të dhënat e fundit nga Strategjia Kombëtare Sektoriale të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2022-2030 evidentojnë se zonat urbane gëzojnë një akses shumë më të lartë në furnizimin me ujë (93.5%) dhe kanalizime (82.1%), krahasuar me zonat rurale, ku aksesin në furnizimin me ujë e ka vetëm 57.8% dhe në kanalizime vetëm 14.5%.




FIGURA 13: FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM DHE TREGUESIT SANITARË

Qeverisja dhe transparenca

Burimet njerëzore

Menaxhimi i burimeve njerëzore përfshin jo vetëm plotësimin e vendeve të punë të qëndrueshme, por edhe përshtatjen e aftësive të punonjësve me nevojat në zhvillim të komuniteteve vendore. Bashkitë përballen me sfida të veçanta, duke përfshirë diferencat në madhësitë e popullsisë, kufizimet buxhetore dhe luhatjet politike.

Shërbimi Civil Shqiptar: Administrata e apartatit të Bashkive i nënshtrohet rregullave të shërbimi civil shqiptar i cili rregullohet nga Ligji nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar, i cili krijon një shërbim civil profesional, të bazuar në meritë dhe politikisht asnjansë.

Vlerësimi i burimeve njerëzore për vitin 2023 në 61 bashkitë hedh dritë mbi çështje kritike në rekrutimin, trajnimet dhe shpërndarjen e punonjësve. Përdoren tre tregues kryesorë: i) shkalla e rotacionit, ii) pjesëmarrja në trajnim dhe iii) raportet e punonjësve ndaj popullsisë. Analiza ofron informacione të vlefshme mbi paraqitjen e burimeve njerëzore në bashki me madhësi dhe kushte të ndryshme (figura 14).




FIGURA 14: INDIKATORI I BURIMEVE NJERËZORE

Shkalla e rotacionit

Të dhënat treguan një diferencë të theksuar në rotacionin e stafit nëpër bashki, të cilat u ndikuan veçanërisht nga ndryshimet në drejtimin e kryetarëve të bashkive. Pas zgjedhjeve të vitit 2023, bashkitë me kryetarë të rinj kishin shkallë rotacioni shumë më të lartë, me një mesatare prej 17.1%, gati dy herë më shumë se në bashkitë me kryetarë në detyrë (10.3%). Disa bashki zëvendësuan më shumë se gjysmën e personelit pas ndryshimeve të kryetarëve. Tirana regjistron shkallën më të ulët të rotacionit, vetëm 2.3%, duke treguar kushte pune më të qëndrueshme.

Përqindja e stafit të trajnuar

Bashkitë me popullsi më të vogël (deri në 10,000 banorë) kanë 9.5% të stafit të trajnuar, ndërsa bashkitë me popullsi të mesme (10,000–50,000 banorë) shfaqnin një grafik pak më të ulët prej 8.2%. Megjithatë, gjetja më e dukshme vjen nga bashkia Tiranë, ku një përqindje prej 14% e forcës punëtore ka marrë të paktën një formë trajnimi, normë kjo më e lartë se mesatarja 9%.

Raporti punonjës për banorë

Analiza e raportit të punonjësve ndaj banorëve tregon se bashkitë më të vogla (me popullsi deri në 20,000) kanë një raport më të lartë, mesatarisht 37 punonjës për 1,000 banorë, që është 55% më shumë se mesatarja kombëtare.

Tirana mban nivele të punësimit që i kalojnë ato të bashkive të tjera të mëdha në pothuajse të gjitha kategoritë e shërbimeve me 14 punonjës për banorë (nën mesataren 16 punonjës). Kjo mund t'i jepet si meritë kompleksitetit më të madh të administrimit të shërbimeve në kryeqytet, i cili i shërben një popullatë urbane më të madhe.

Në përfundim, paraqitja e përgjithshme në burimet njerëzore lidhet me madhësinë e bashkisë. Bashkitë më të mëdha si Tirana kanë menaxhim të organizuar të burimeve njerëzore, norma më të larta trajnimi dhe qëndrueshmëri më të lartë të personelit. Bashkitë më të vogla vazhdojnë të ruajnë praktika efektive të burimeve njerëzore, pavarësisht se kanë më pak burime në dispozicion. Kjo sugjeron se cilësia e udhëheqjes dhe strategjitë e administrimit mund të kompensojnë kufizimet e burimeve.

Transparenca dhe llogaridhënia

E drejta për informacion është një e drejtë themelore e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe është sanksionuar në Ligjin Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” i ndryshuar.

Vlerësimi mbështetet në dy tregues kryesorë: përqindja e vendimeve të Këshillave Bashkiakë të publikuara online dhe përqindja e projekt-akteve të përfshira në konsultim publik. Të dhënat e paraqitura në figurën 15, tregojnë se bashkitë përmbushin detyrimet për transparencë me treguesin e publikimeve online të vendimeve me 91%, dhe shkallën e projektakteve për të cilat është kryer konsultim publik 88%.

Të dhënat tregojnë një rezultat pozitiv për transparencën e veprimtarisë bashkiake dhe nxjerrin në dukje përpjekjet për përfshirjen e komunitetit në vendimmarrje. Informacioni mund të përcillet më lehtë qytetarëve përmes përdorimit më të lartë të teknologjisë. Bashkitë më të mëdha, duket se kanë krijuar sistemet dhe proceset e nevojshme me standardet e larta të transparencës dhe konsultimit publik.




FIGURA 15: INDIKATORI I TRANSPARENCËS

Barazia Gjinore

Ligji “Për Barazinë Gjinore”, i miratuar në vitin 2008, përcakton parimet themelore të barazisë gjinore duke legjitimuar pjesëmarrjen e barabartë në të gjitha aspektet e jetës për gjininë femërore dhe mashkullore.

Vlerësimi tregoi se përqindja e grave në qeverisjen vendore është mesatarisht 44%. Bashkitë më të vogla raportojnë një përqindje më të ulët të grave në pozicione drejtuese, me ato nën 10000 banorë që arrijnë në 37%. Ndërsa rritet madhësia e bashkisë, rritet edhe përfaqësimi i grave, duke arritur 44% në zonat me mbi 50,000 banorë dhe deri në 61% në Tiranë. Bashkitë më të vogla dhe ato me zhvillim ekonomik më të kufizuar kanë një përfaqësim më të ulët gjinor.

FIGURA 16: PËRQINDJA E GRAVE NË POZICIONE DREJTUESE

Përqindja e grave në pozicione drejtuese

Sipas popullsisë



Densiteti i bizneseve



Projektet e huaja dhe me donatorë

Analiza synon të ofrojë një pasqyrë të plotë të ecures së bashkive në Shqipëri për zbatimin e projekteve të financuara nga burime të huaja gjatë periudhës 2017-2024, ajo mbështetet në të dhënat e platformës së vetë-raportimit të Njësisë të Integritetit Evropian dhe projektit "Bashkitë për në Evropë", duke pasqyruar ndryshimet vjetore dhe sfidat në përthithjen e granteve.

Sipas të dhënave të Platformës së Vetë-deklarimit të Projekteve të Bashkive, 53 bashki kanë përfituar projekte nga donatorët, ndërsa 8 bashki nuk kanë mundur të përfitojnë nga ato. Bashkitë që kanë realizuar më shumë projekte janë Berat (20 projekte), Gjirokastrë (17 projekte) dhe Përmet (13 projekte), të cilat kanë siguruar më shumë fonde nga donatorët dhe partnerët ndërkombëtar.

Shuma totale e granteve nga donatorët arrin në vlerën 46,174,419 €, prej të cilave 54% e tyre mbulohet nga Bashkimi Evropian. Bashkitë e vogla rezultojnë me nivelin më të lartë të fondeve për frymë prej 65€ për banorë, ndërsa bashkia Tiranë rezulton me vlerën më të ulët prej 6€ për banorë.





FIGURA 17: FONDET E DONATORËVE DHE TOTALI I PROJEKTEVE

- Fondet mesatare për frymë nga donatorët dhe bashkia janë më të larta në bashkitë më të vogla. Kjo mund të tregojë se bashkitë më të vogla kanë nevojë për më shumë mbështetje financiare për frymë, ose se ato janë më të suksesshme në tërheqjen e fondeve.
- Fondet mesatare të financuara nga donatorët janë dukshëm më të larta se fondet e financuara nga bashkia në të gjitha kategoritë e popullsisë. Kjo tregon se donatorët luajnë një rol të rëndësishëm në financimin e projekteve në bashki.
- Tirana është një rast i veçantë. Edhe pse është bashkia më e madhe, ajo ka fondet më të ulëta mesatare për frymë nga donatorët dhe bashkia. Megjithatë, ajo ka fondet më të larta totale të financuara nga donatorët dhe numrin më të madh të projekteve të përfituara. Kjo mund të tregojë se Tirana ka më shumë kapacitet për të menaxhuar projekte të mëdha dhe për të tërhequr fonde të mëdha nga donatorët.
- Numri mesatar i projekteve të përfituara nga donatorët rritet me madhësinë e popullsisë së bashkisë. Kjo mund të tregojë se bashkitë më të mëdha kanë më shumë nevojë për projekte të financuara nga donatorët, ose se ato janë më të suksesshme në aplikimin për fonde.

Figura 18 pasqyron përqindjen e projekteve të shpërndara sipas sektorëve në bashki, duke theksuar prioritetet kryesore:

- **Zhvillimi Ekonomik dhe Turizmi** përfaqëson 24.2% të projekteve me vlerë 11 milion euro, duke theksuar angazhimin për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e turizmit lokal.
- **Bujqësia, Mjedisi dhe Pyjet** zë 23.5% me vlerë afërsisht 11 milion euro, duke reflektuar përpjekjet për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e bujqësisë.



- **Shëndetësia dhe Shërbimi Social:** ka numrin më të madh të projekteve, por me fonde relativisht më të pakta, që tregon se projektet në këtë fushë mund të jenë më të vogla në shkallë.
- **Infrastruktura:** Tërheq fonde të konsiderueshme me mbi 9 milionë euro, duke theksuar nevojën për investime në infrastrukturë.
- **Kulturë, Sport, Rini:** ka një numër të mirë projektesh, por me fonde më të pakta se kategoritë e lartpërmendura.
- **Arsimi, Digitalizimi dhe Siguria Publike:** këto kategori marrin fondet dhe numrin më të vogël të projekteve, duke treguar se mund të jenë prioritetë më të ulëta në këtë kontekst.

Përfundime dhe Sfidat

Nga rezultatet, vëmë re një përmirësim të veprimtarive bashkiake për sa i përket ecurisë së shërbimeve dhe situatës financiare.

- **Ekonomitë e shkallës karakterizojnë pothuajse çdo funksion të bashkive:** sa më e madhe Bashkia aq më e mirë performanca. Kemi një korrelacion të fortë midis madhësisë së Bashkisë dhe aftësisë për të performuar dhe për të ushtruar të gjitha funksionet e shërbimeve. Sa më shpesh ofrohet një shërbim aq më pak na kushton. Kjo ndodh sidomos për shkak të specializimit të bashkive më të mëdha. Kemi një korrelacion të qartë midis madhësisë së bashkisë dhe numrit të stafit. Diferenca midis bashkisë më të pak staf dhe asaj më të shumë staf është 5 herë.
- **Autonomia financiare është rritur:** 7 bashki kanë arritur autonominë financiare duke u bërë më pak të varura nga transfertat e pakushtëzuar. Në vitin 2015, të ardhurat e veta të bashkive përfaqësonin vetëm 36% të të ardhurave të veta kundrejt transfertës së pakushtëzuar, krahasuar me normën 51% që rezultoi në vitin 2023.
- **Disiplina financiare është përmirësuar:** Që prej vitit 2015, vëmë re përgjegjshmërinë e njësisë të vetëqeverisjes vendore në shpenzimin e fondeve dhe administrimin e detyrimeve të prapambetura.
- **Investimet janë rritur:** Në lidhje me investimet mesatarja kombëtare për frymë shënon 6,724 lekë, ku niveli minimal arrin në 5,004 lekë dhe niveli maksimal në 9,546 lekë (Tirana). Me funksione të shtuara dhe situatën pozitive financiare reagimi del në pah me rritjen e investimeve dhe përmirësimin e parametrave të shërbimeve. Nëse para reformës, një pjesë e konsiderueshme e bashkive e shfrytëzonin buxhetin e tyre për shpenzime pagash dhe sigurimesh shoqërore, nga rezultatet e analizës vëmë re orientimin e shpenzimeve drejt shërbimeve dhe investimeve.

SFIDAT

- **Rritja e të ardhurave të veta:** Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore përmes rritjes së peshës së taksave lokale në të ardhurat vendore. Të ardhurat e veta të pushtetit vendor nga viti 2015 në vitin 2025 parashikohen me një rritje të ndjeshme me rreth 20 miliard lekë, ndërkohë krahasuar me vitin 2024 parashikohet të rriten me rreth 3.6 miliard lekë, ose 10 % më shumë.
- **Zhvillimi i kadastrës fiskale** për të maksimizuar të ardhurat nga taksa e pronës. Masa të tjera duhet të zbatohen në lidhje me planifikimin e saktë financiar dhe zvogëlimin e volumit të detyrimeve të prapambetura. Aktualisht, është në diskutim rishikimi i formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar. Të mirat materiale të NJVV-ve duhet të regjistrohen, inventarizohen dhe përdoren si pasuri ekonomike, të cilat mund të jepen me qira, të përdoren për të zhvilluar projekte të përbashkëta me partnerë privat ose të shiten tek palë të treta.

- **Shërbimet digjitale** në nivel vendor ofrohen në mënyrë kufizuar në krahasim me shërbimet në nivel qeverisje qendrore. Nisur nga nevojat për të digjitalizuar hapësirën e komunikimit publik, shërbimeve dhe administratës, parashikohet automatizimi dhe digjitalizimi i shërbimeve vendore si një proces i unifikuar në të gjithë territori pasi do plotësonte kriterin e standardeve kombëtare.
- **Funksionet ndërbashkiake** janë sporadike edhe pse Ligji Nr. 139 për “Vetëqeverisjen Vendore” ofron kushtet për dy ose më shumë NJVV që ushtrojnë funksione komplekse ose jo në mënyrë të përbashkët me marrëveshje.

ANGAZHIMET

- **Administratë të qëndrueshme dhe të mirëtrajnuar:** Me rritjen e pagave gjatë vitit 2024, Bashkitë kanë mundësi më të mëdha për të mbajtur punonjësit ekzistues dhe të jenë më tërheqëse për punonjësit e rinj. Shkalla e rotacionit volitet të jetë nën 5% dhe e pandikuar nga ndryshimet e zgjedhjeve vendore. Mbështatetja e qeverisë në rritjen e pagave në buxhetin vendor 2025 për të mbuluar efektin financiar shtesë për rritjen e kufirit minimal të nivelit të pagave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, me një fond shtesë prej 3.5 miliard lekë. (Vendimi i Këshilli të Ministrave nr.328 datë 31.5.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar). Gjithashtu, me ngritjen e Qendrës për trajnimin e punonjësve dhe të zgjedhurve të NJVV-ve do synojë trajnimin vjetor të së paku 25% të punonjësve.
- **Decentralizimi pilot:** procesi i decentralizimit do të vijojë gjatë vitit 2025, me zbatimin e projektit pilot ndërmjet 4 bashkive (Berat, Divjakë, Kolonjë dhe Shkodër) dhe ministrive të linjës në fushat e kujdesit parësor, arsimit dhe zhvillimit bujqësor.
- **Rishikimi i formulës së transfertës së pakushtëzuar:** ka nisur procesi i rishikimit të formulës për shkak të situatës së re demografike dhe nevojës për të përfshirë skema incentivuese në transfertat.
- **Granti i performances:** së bashku me projektin “Bashki të Forta” përgjatë vitit 2025-2026 do të përdoren rreth 6 milionë euro për të nxitur bashkitë në hartimin e Planeve për mbarështimin e pyjeve, administrimin e arsimit parauniversitar, menaxhimin e mbetjeve, zhvillimin ekonomik, mbështetjen sociale, barazinë gjinore dhe përmirësimin e raporteve të performances.

Anekset


Aneks A. Tabela e klasifikimit/kategoritë

Bashkia	Madhësia sipas popullsisë	Densitetit i bizneseve	Lloji I tokës	Lloji i menaxhimit të mbetjeve	Ndryshimi i kryebashkiakut në 2023
Belsh	10'000-50'000	E ulët	Bujqësore	Nënkontraktim	Në detyrë
Berat	50'000-150'000	E ulët	E përzierë	Nënkontraktim	Në detyrë
Bulqizë	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Vetëmenaxhimi	Kryetar i ri
Cërrik	10'000-50'000	E ulët	Bujqësore	Nënkontraktim	Në detyrë
Delvinë	deri në 10'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Kryetar i ri
Devoll	10'000-50'000	E ulët	E përzierë	Nënkontraktim	Në detyrë
Dibër	50'000-150'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Në detyrë
Dimal	10'000-50'000	E ulët	Bujqësore	Nënkontraktim	Në detyrë
Divjakë	10'000-50'000	E ulët	Bujqësore	Vetë-administrim	Kryetar i ri
Dropull	deri në 10'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Në detyrë
Durrës	50'000-150'000	E lartë	Bujqësore	Nënkontraktim	Në detyrë
Elbasan	50'000-150'000	E mesme	Pyje	Nënkontraktim	Në detyrë
Fier	50'000-150'000	E mesme	Bujqësore	Nënkontraktim	Në detyrë
Finiq	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Kryetar i ri
Fushë-Arrëz	deri në 10'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Kryetar i ri
Gjirokastrë	10'000-50'000	E mesme	E përzierë	Vetë-administrim	Në detyrë
Gramsh	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Nënkontraktim	Kryetar i ri
Has	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Kryetar i ri
Himarë	deri në 10'000	E lartë	Pyje	Nënkontraktim	Kryetar i ri
Kamëz	50'000-150'000	E ulët	Bujqësore	Nënkontraktim	Në detyrë
Kavajë	10'000-50'000	E lartë	Bujqësore	Nënkontraktim	Kryetar i ri
Këlcyrë	deri në 10'000	E ulët	E përzierë	Vetë-administrim	Në detyrë
Klos	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Kryetar i ri
Kolonjë	deri në 10'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Në detyrë
Konispol	deri në 10'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Kryetar i ri
Korçë	50'000-150'000	E mesme	Pyje	Nënkontraktim	Në detyrë
Krujë	50'000-150'000	E ulët	E përzierë	Nënkontraktim	Në detyrë
Kuçovë	10'000-50'000	E ulët	Bujqësore	Nënkontraktim	Në detyrë
Kukës	10'000-50'000	E ulët	E përzierë	Vetë-administrim	Në detyrë
Kurbin	10'000-50'000	E ulët	E përzierë	Nënkontraktim	Në detyrë
Lezhë	50'000-150'000	E lartë	E përzierë	Vetë-administrim	Në detyrë
Libohovë	deri në 10'000	E ulët	E përzierë	Vetë-administrim	Kryetar i ri
Librazhd	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Nënkontraktim	Kryetar i ri
Lushnjë	50'000-150'000	E mesme	Bujqësore	Nënkontraktim	Në detyrë
Malësi e Madhe	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Në detyrë
Maliq	10'000-50'000	E ulët	E përzierë	Nënkontraktim	Në detyrë
Mallakastër	10'000-50'000	E ulët	E përzierë	Vetë-administrim	Në detyrë
Mat	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Nënkontraktim	Në detyrë
Memaliaj	deri në 10'000	E ulët	Pyje	Nënkontraktim	Kryetar i ri
Mirditë	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Nënkontraktim	Kryetar i ri
Patos	10'000-50'000	E ulët	Bujqësore	Vetë-administrim	Kryetar i ri
Peqin	10'000-50'000	E ulët	Bujqësore	Nënkontraktim	Kryetar i ri
Përmet	deri në 10'000	E mesme	E përzierë	Vetë-administrim	Në detyrë
Pogradec	10'000-50'000	E mesme	E përzierë	Nënkontraktim	Në detyrë
Poliçan	deri në 10'000	E ulët	E përzierë	Nënkontraktim	Në detyrë
Prrenjas	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Nënkontraktim	Në detyrë
Pukë	deri në 10'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Kryetar i ri
Pustec	deri në 10'000	E ulët	E përzierë	Vetë-administrim	Në detyrë
Roskovec	10'000-50'000	E ulët	Bujqësore	Vetë-administrim	Në detyrë
Rrogozhinë	10'000-50'000	E mesme	Bujqësore	Vetë-administrim	Në detyrë
Sarandë	10'000-50'000	E lartë	E përzierë	Nënkontraktim	Kryetar i ri
Selenicë	deri në 10'000	E ulët	E përzierë	Vetë-administrim	Kryetar i ri


Bashkia	Madhësia sipas popullsisë	Densitetit i bizneseve	Lloji I tokës	Lloji i menaxhimit të mbetjeve	Ndryshimi i kryebashkiakut në 2023
Shijak	10'000-50'000	E mesme	Bujqësore	Vetë-administrim	Në detyrë
Shkodër	50'000-150'000	E mesme	E përzierë	Nënkontraktim	Kryetar i ri
Skrapar	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Nënkontraktim	Në detyrë
Tepelenë	deri në 10'000	E lartë	Pyje	Vetë-administrim	Në detyrë
Tiranë	Tirana	E lartë	E përzierë	Nënkontraktim	Në detyrë
Tropojë	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Vetë-administrim	Në detyrë
Vau-Dejës	10'000-50'000	E ulët	Pyje	Nënkontraktim	Kryetar i ri
Vlorë	50'000-150'000	E lartë	E përzierë	Nënkontraktim	Kryetar i ri
Vorë	10'000-50'000	E lartë	Bujqësore	Nënkontraktim	Në detyrë

TABELA 2: TABELA E KLASIFIKIMIT


Aneks B. Financat FINANCAT | Të ardhurat e veta për frymë në lekë




FINANCAT | Peshë e të ardhurave të veta në buxhet (Të ardhurat e veta vs. Transferte në %)




FINANCAT | Raporti i të ardhurave të veta ndaj buxhetit në %




FINANCAT | Shkalla e përdorimit të të ardhurave (të ardhura vs. shpenzime, në %)




FINANCAT | Shkalla e përdorimit të të ardhurave (të ardhura vs. shpenzime, në %)




FINANCAT | Buxheti për frymë në lekë




FINANCAT | Realizimi i buxheut: fakt vs. plan (në %)




FINANCAT | Investime për frymë në lekë




FINANCAT | Realizimi i shpenzimeve për investime (në %)



FINANCAT | Pësha e shpenzimeve të personelit në totalin e buxhetit të bashkisë (në %)




FINANCAT | Pesha e shpenzimeve operative në buxhet (në %)




Aneks D. Shërbimet

ARSIMI | Shkalla e regjistrimit në çerdhe publike për fëmijët e moshës 0 deri në 3 vjeç




ARSIMI | Shkalla e regjistrimit në kopshte publike për fëmijët e moshës 3 deri në 6 vjeç




Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, viti shkollor 2023-2024

ARSIMI | Shkalla e regjistrimit në kopshte publike dhe private për fëmijët e moshës 3 deri në 6 vjeç




Burimi: Ministria Arsimit dhe Sportit, 2023-2024

ARSIMI | Shkalla e mirëmbajtjes së objekteve të arsimit parashkollor dhe arsimit bazë




Burimi: Të dhëna të raportuara nga vetë bashkitë për 2023

ARSIMI | Raporti fëmijë-mësues në kopshte publike




Burimi: Të dhëna të raportuara nga vetë bashkitë për 2023

BUJQESIA | Shkalla e mirëmbajtjes së kanaleve të ujërës




BUJQESIA | Shkalla e mirëmbajtjes së kanaleve të kullimit




Burimi: Të dhëna të raportuara nga vetë bashkitë për 2023

BUJQESIA | Përqindja e tokës bujqësore të pajisur me kanale ujitje/kullimi




PYJE DHE KULLOTA | Shkalla e pajisjes së fondit pyjor dhe kullosor me plane mbarështimi (%)




Burimi: Të dhëna të raportuara nga vetë bashkitë për 2023


PYJE DHE KULLOTA | Punonjës për 1000 hektarë




MBROJTJA NGA ZJARRI | Zjarrfikës për 1500 banorë



MBROJTJA NGA ZJARRI | Automjete zjarrfikëse për 10000 banorë




MENAXHIMI I MBETJEVE | Përqindja e popullsisë e mbuluar me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve




Burimi: Të dhëna të raportuara nga vetë bashkitë për 2023


MENAXHIMI I MBETJEVE | Shkalla e mbulimit të kostos së shërbimit të menaxhimit të mbetjeve nga të ardhurat e tarifës së shërbimit (%)



MENAXHIMI I MBETJEVE | Mbetjet e gjeneruara si kg/banor




MENAXHIMI I MBETJEVE | Efikasiteti i kostos së menaxhimit të mbetjejeve (Kosto per tonë)



Burimi: Të dhëna të raportuara nga vetë bashkitë për 2023


*) Te dhënat për Tropojën nuk janë raportuar

SHËRBIMET SOCIALE | Përqindja e familjeve që marrin ndihmë ekonomike




Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Social, Dhjetor 2023

SHËRBIMET SOCIALE | Shkalla e miratimit të strehimit social




SHËRBIMET SOCIALE| Numri i qendrave komunitare sociale publike për 10000 banorë




Burimi: Të dhëna të raportuara nga vetë bashkitë për 2023

UJI I PËRSHËM DHE KANALIZIMET | Përqindja e kontratave familjare të ujësjellësit në raport me numrin e banesave




Burimi: AKUM (Agjensia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve), 2023

UJI I PËJSHËM DHE KANALIZIMET | Përqindja e banesave të lidhura me sistemin e kanalizimeve




Burimi: Të dhëna të raportuara nga vetë bashkitë për 2023


Aneks D. Qeverisja dhe transparencia
BURIMET NJERËZORE | Shkalla e rotacionit të punonjësve të bashkisë (%)




BURIMET NJERËZORE | Shkalla e punonjësve të bashkisë të trajnuar gjatë vitit 2023 (%)




BURIMET NJERËZORE | Punonjës për 1000 banorë




MIRËQEVERISJA | Shkalla e publikimit online të vendimeve të bashkisë (%)




MIRËQEVERISJA | Shkalla e projektakteve per të cilat është bërë konsultim publik (%)




MIRËQEVERISJA | Barazia gjinore - Përqindja e grave në qeverisjen lokale




PROJEKTET | Fondet total nga donatorët dhe bashkia në lidhje me projektet e huaja në milionë euro



PROJEKTET |Fondet e financuara nga donatorët në lidhje me projektet e huaja në milionë euro



PROJEKTET | Fondet e financuara nga bashkia në lidhje me projektet e huaja në milionë euro



PROJEKTET | Numri i projekteve të përfituara nga donatorët

